



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO



KOMUNA SHTIME  
OPŠTINA ŠTIMLJE/MUNICIPALITY OF SHTIME

Drejtoria për Shërbime Publike  
Uprava za Javne Službe/Directorate of Public Service

|                       |                                                                                                                                                     |
|-----------------------|-----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| Data/ Datum/Date      | 14.02.2025                                                                                                                                          |
| Nr/Br/ No             | 08/06                                                                                                                                               |
| Për/Za/To             | Kuvendin Komunal Shtime                                                                                                                             |
| Përmes/Preko/Through  | Kryetari i Komunës: <b>Qemajl Allu</b>                                                                                                              |
| Nga/Od/From           | Drejtori i Shërbimeve Publike: <b>Bardhyl Rushiti</b>                                                                                               |
| Lënda/Predmet/Subject | Propozim për Miratim i Draft Planit Ndërkomunal për Menaxhimin e Integruar të Mbeturinave për Rajonin e Gjilanit dhe Ferizajt pas diskutimit publik |

Drejtoria e Shërbimeve Publike, i propozon Kuvendit miratimin e Draft Planit Ndërkomunal për Menaxhimin e Integruar të Mbeturinave për Rajonin e Gjilanit dhe Ferizajt pas diskutimit publik të mbajtur më datë **11 Shkurt 2025 (e martë) duke filluar nga ora 14:00** në Sallën e Kuvendit të Komunës së Shtimes.

*Pjesëmarrës në takim ishin Drejtori i Drejtorisë për Shërbime Publike, Bardhyl Rushiti, zyrtarë komunal dhe qytetar.*

Mbledhja është hapur nga **Bardhyl Rushiti Drejtor për Shërbime Publike** i cili para të pranishmëve prezantoi qëllimin e takimit.

**Bardhyl Rushiti:** Përshëndetje të nderuar të pranishëm, ashtu si jeni njoftuar sot po mbahet dëgjimi publik për draft Planin Ndërkomunal për Menaxhimin e Integruar të Mbeturinave për Rajonin e Gjilanit dhe Ferizajt, draft ky i cili i është prezantuar Kuvendit të Komunës së Shtimes dhe i njëjti ka vendosur që ta dërgojë në diskutim publik e pastaj pas diskutimit publik të dërgohet për miratim. Ky plan ka për qëllim që të fillohet me një hap të ri të trajtimit të mbetjeve si nga ndërtim demolimi poashtu edhe të mbeturinave të amvisrisë duke aplikuar metodat e Riciklimit dhe të Kompostimit. Me këtë rast po e hapi edhe diskutimin për të pranishmit në sallë.

**Hysen Hoxha-Qytetar:** Fillimisht uroj komisionin që e ka realizuar punën në përgatitjen e këtij plani i cili synon të reduktoj mbeturinat dhe të krijoj një mjedis të pastër për të gjithë.

*Unë si qytetar dëshiroj që këto plane të kenë zbatimin e duhur në teren dhe qytetarëve të ju ofrohet një mjedis më i pastër e jo çdo vend të shofim hudhje të mbeturinave duke na krijuar deponi ilegale.*

Nuk kishte diskutime tjera nga të pranishmit andaj **Drejtori për Shërbime Publike Bardhyl Rushiti** i falënderoj të pranishmit dhe i siguroj që ky planë do të bëjë zgjidhje të qëndrueshme sa i përket mbeturinave.

Për hartimin e këtij Draft dokumenti janë marr në konsiderat këto ligje: Ligji Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, Ligji Nr.04/L-060 për Mbeturina, Ligji Nr.03/L-025 për Mbrotjen e Mjedisit, Ligji Nr.03/L-214 për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis, Ligji Nr.03/L-043 për Parandalimin dhe Kontrollin e Integruar të Ndotjes, Ligji Nr.08/L-025 për Mbrotjen e Ajrit nga Ndotja, Ligji Nr.04/L-197 për Kimikate, Ligji Nr.03/L-233 për Mbrotjen e Natyrës, Ligji Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik në Republikën e Kosovës, Ligji Nr.04/L-045 për Partneritetin Publiko-Privat, Ligji Nr.03/L-087 për Ndërrmarrjet Publike.

Hartimi i Draft Planit Ndërkomunal për Menaxhimin e Integruar të Mbeturinave për Rajonin e Gjilanit dhe Ferizajt është në harmoni edhe me veprimet dhe masat në nivel lokal të përcaktuara me dokumente strategjike lokale.

Objektivi kryesor i planit është sigurimi i praktikave më të mira të menaxhimit mjedisor për fraksionet e mbeturinave të krijuara në rajone, duke përfshirë masat për parandalimin e mbeturinave dhe për minimizimin e gjenerimit të mbeturinave.

Të bashklidhur e gjeni Draft Planin Ndërkomunal për Menaxhimin e Integruar të Mbeturinave për Rajonin e Gjilanit dhe Ferizajt dhe Vlerësimin Strategjik Mjedisor (VSM) të këtij plani.

Me respekt!